



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Prishtinë, 11.03. 2013  
Nr.0204-252

**Për: Mehmet Krasniqi, Kryetar i Komunës së Obiliqit,**  
**Hajriz Bektashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës,**

**Lënda: Shqyrtimi i ligjshmërisë së Vendimit të komunës**

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar Vendimin Nr. 03, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit me datë 25 janar 2013, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Kuvendi i Komunës së Obiliqit, ka nxjerr vendim me të cilin ka obliguar Drejtorinë Komunale për Pronë, Urbanizëm, Kadastër dhe Planifikim, për mos lëshimin e lejeve për realizimin e projektit të ngrohjes së Qytetit të Prishtinës, projekt i cili do të kyqet nga TC "Kosova B", duke kushtëzuar edhe me futjen e komunës së Obiliqit në këtë projekt.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe mandatin ligjor të përcaktuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L040, si dhe Ligjin për Ndërmarrje Publike dhe pas shqyrtimit të hollësishëm të këtij vendimi, ka konstatuar se vendimi i Kuvendit të Komunës së Obiliqit është ***kundërligjshëm, për faktin se:***

- Bazuar në nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës nuk ka kompetencë ligjore, për të obliguar administratën komunale me këtë rast Drejtorinë Komunale për Pronë, Urbanizëm, Kadastër dhe Planifikim, për mos lëshimin e lejeve të punës, nëse plotësohen kushtet ligjore dhe procedura administrative.
- Për lëshimin e lejeve të punës, ushtrohet procedurë administrative konform kërkesave të parashtruara nga palët, dhe nëse kërkesa plotëson kriteret ligjore dhe procedurën administrative, atëherë organi i administratës së komunës është i obliguar t'i përgjigjet kërkesave brenda afatit ligjor të përcaktuar në Ligjin e Procedurës Administrative apo ligjin përkatës sektorial.
- Bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 Korporata Elektroenergjetike e Kosovës (KEK) rangohet në Listën 1 të Ndërmarrjeve Publike Qendrore dhe komunat nuk kanë kompetencë ligjore të ndërhyjnë në, organizimin,


Qendrore dhe komunat nuk kanë kompetencë ligjore të ndërhyjnë në, organizimin, menaxhimin dhe administrimit e tyre, përfshirë edhe realizimin e projektit të Ngrohjes së Qytetit të Prishtinës.

Nga ajo që u tha më lartë dhe me qëllim të zbatimit të plotë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, si dhe Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga autoritetet e Komunës, përkatësisht Kuvendi i Komunës së Obiliqit, që bazuar në afatin ligjor të përcaktuar me nenin 82.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, t'i përgjigjet kërkesës për *rishqyrtimin* e vendimit.

MAPL, është e përkushtuar të ofrojë përkrahje dhe ndihmë të nevojshme për zbatimin e plotë të këtyre obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt,

**Slobodan Petrović**  
Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL



**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL*  
*Udhëheqësve të Departamenteve në MAPL*  
*Arkivit të MAPL-së*





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Priština, 11.03. 2013  
Nr.0204 - 252

**Za: Mehmet Krasniqi, Gradonačelnik opštine Obilić,**  
**Hajriz Bekteshi, Prededavajući Skupštine opštine Obilić,**

**Predmet: Razmatranje zakonitosti odluke opštine Obilić**

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave je primilo odluku br. 03, ofobreno od strane Skupštine opštine Obilić dana 25 januar 2013, sa ciljem procenjivanja zakonitosti .

Skupština opština Obilić , je izdalo odluku sa kojom obavezuje opštinsku direkciju za imovinu,urbanizam,kadastar i planiranje , o ne izdavanju dozvole za realizaciju projekta, grejanje grada Priština projekat koji će se uključiti na TC "Kosova B", uslovljavanjem i uvođenjem opštine Obilć u ovom projektu .

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ,prema nadležnosti i zakonskom mandatu definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br.03/z040, kao i zakona o javnim preduzećima , nakon detaljnijeg razmatranja ove odluke , konstatovano je da odluka Skupštine opštine Obilić je protiv zakonita , *zbog činjenice da :*


- Prema članu 40 zakona o lokalnoj samoupravi , Skupština opština nema zakonsku nadležnost , da obavezuje opštinsku upravu ovim slučajem opštinsku direkciju za imovinu,planiranje,urbanizam i kadastar za ne izdavanje dozvole rada ,*ako se ispunjavaju zakonski uslovi i administrativne procedure.*
- Za izdavanje dozvole rada , vrši se administrativna procedura u skladu sa zahtevima predloženim od strane , i ako zahtev ispunjava zakonske kriterijume i administrativne procedure ,onda organ opštinske uprave dužno je da odgovori zahtevima unu tar jednog zakonskog roka određeno zakonom o administartivnoj proceduri ili dotičnim sektorijskim zakonom.
- Na osnovu zakona o javnim preduzećima br. 03/z-087 KEK) rangira se u 1 -prvoj listi javnih centralnih preduzeća i opštine nemaju zakonsku nadležnost da se mešaju u organizaciji, upravljanju i njihovog menadžmenta, uključujući realizaciju projekta grejanje grada Priština.

Prema gore navedenom kao i u cilju potpunog sprovođenja zakona o lokalnoj samoupravi br.03/z-040, kao i zakona o javnim preduzećima br. 03/z-087, Ministarstvo administracije lokalne samouprave zahteva od strane nadležnosti opštine tačnije Skupštine opštine Obilić , da prema zakonskom mandatu definisano članom 82.2 zakona o lokalnoj samoupravi , da odgovori na zahtev o ponovnom razmatranju odluke.

MALS , je posvećeno da pruža potrebnu pomoć i podršku u cilju potpunog sprovođenja ovih dužnosti koje proističu od strane sprovodljivog zakonodavstava u Republici Kosvo.

Sa poštovanjem,

**Slobodan Petrović**  
Zamenik premijera i Ministar MALS-a



**Kopije:** *Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*  
*Rukovodiocima odeljenja MALS-a*  
*Arhivi MALS-a*



№ 1-03 Datë 28.01.2013  
B. OBILIGIMIT Datim



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Kuvendi Komunal Obilq - Skupština Opštine Obilje - Municipality Assembly Obilje

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/11-03/12, nën titullin "Rregullores së punës të Kuvendit Komunal në mbledhjen e mbajtur me dt. 25.01.2013, mbi këtë:

**V E N D I M**

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Municipality of Local Government Administration Kuvendi Komunal Obilq - Skupština Opštine Obilje			
Data: <u>04.03.2013</u>			
Niveli i Ligjit: <u>II</u>			
Niveli i Dokumentit: <u>0074-262</u>			
Shtypja: <u>        </u>			
Vendi: <u>        </u>			

- I. Obligohet Ekzekutivi i Komunës që të bashkëpunoj me institucionet e projektit të ngrohjes qëndrore të qytetit të Prishtinës, projekt i cili do të kryhet nga TC "Kosova B".
- II. Obligohet DPUPK, që të mos lëshoj leje pune për këtë projekt në territorin e Komunës së Obilqit, derisa marrëveshja e arritur të fuqizohet nga të dy palët, Komuna e Obilqit dhe institucionet që e financojnë këtë projekt.
- III. Kuvendi komunal kërkon që gjithsesi në këtë projekt të përfshihet edhe qyteti i Obilqit si shpërbim për të gjitha dëmet që i shkaktohen kësaj Komune.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.